

07 / 12 / 2022

VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM
Nr 04 date 07 Dhjetor 2022

- PER EMERIMIN E AUDITUESIT LIGJOR (EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR) PER TE BERE VLERESIMIN KONABEL TE KAPITALEVE TE SHOQERISE.

Sot me date 07 Dhjetor 2022 ne oren 10:30 ne seline e shoqerise "CENTRAL PHARMA GROUP" Shpk u mbledh ortaku i vetem i Shoqerise.

DUKE QENE SE ne mbledhje eshte prezent personalisht ortaku i vetem i shoqerise perkatesisht:

- (i) Z. Qamil DIKA - shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoteron 100% te kuotave ne shoqerine "CENTRAL PHARMA GROUP" Shpk, me Nr. personal I50626085E.

Asambleja ka per **rend dite**:

1. Emerimin e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabel te Regjistruar) Z. Arber GJATA me Licensen profesionale Nr. 245 te dates 27.08.2012 per kryerjen e misionit te Vleresimit Kontabel te kapitaleve te shoqerise.
2. Te kryhet zmadhimi i kapitalit themeltar me te dhenat si me poshte:
 - a. Brenda grupit te kapitaleve te veta, te kalojne ne kapitalin themeltar shumat ne total prej 2,890,000 Leke duke e cuar Kapitalin e nenshkruar fillimisht ne nje total prej 2,990,000 Leke nga te cilat:
 - i. 2,890,000 leke nga Rezerva te tjera krijuar ne vitin 2022
 - b. Te rritet kapitali i nenshkruar nga fonde te ortakut te vetem edhe me nje shtese prej 2,800,000 lekesh duke arritur ne perfundim Kapitali i nenshkruar ne nje total prej 5,790,000 Leke nga te cilat:
 - i. 2,800,000 leke nga te cilat vijne nga marredheniet e punes se ushtruar ne Republiken e Shqiperise (respektivisht te perfituara nga vitet 2019 deri 2021)

Ne perfundim te diskutimeve ortakut i vetem i shoqerise :

VENDOSI:

1. Emerimin e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabel te Regjistruar) Z. Arber GJATA me Licensen profesionale Nr. 245 te dates 27.08.2012 per kryerjen e misionit te Vleresimit Kontabel te kapitaleve te shoqerise.
3. Te kryhet zmadhimi i kapitalit themeltar me te dhenat si me poshte:
 - a. Brenda grupit te kapitaleve te veta, te kalojne ne kapitalin themeltar shumat ne total prej 2,890,000 Leke duke e cuar Kapitalin e nenshkruar fillimisht ne nje total prej 2,990,000 Leke nga te cilat:
 - i. 2,890,000 leke nga Rezerva te tjera krijuar ne vitin 2022
 - b. Te rritet kapitali i nenshkruar nga fonde te ortakut te vetem edhe me nje shtese prej 2,800,000 lekesh duke arritur ne perfundim Kapitali i nenshkruar ne nje total prej 5,790,000 Leke nga te cilat:
 - i. 2,800,000 leke nga te cilat vijne nga marredheniet e punes se ushtruar ne Republiken e Shqiperise (respektivisht te perfituara nga vitet 2019 deri 2021)
1. Vendimi perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe nenshkruhet rregullisht nga ortakja e vetme e shoqerise. Ky vendim hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te tij.
 - a. Nje kopje i dorezohet Qendra Kombetare e Biznesit Tirane
 - b. Nje kopje i dorezohet Ekspertit Kontabel te Regjistruar.
 - c. Nje kopje mbahet prane arkives se shoqerise CENTRAL PHARMA GROUP Sh.p.k.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Qamil DIKA



9 DHJETOR 2022

RAPORT I ZMADHIMIT TE KAPITALIT
ME KONTRIBUT NGA REZERVA TE TJERA DHE NGA FONDE TE ORTAKUT TE
VETEM

PERGATITUR NGA: ARBER GJATA - AUDITUES LIGJOR
LICENSA NR. 245 DT. 27.08.2012

SHOQERIA TREGETARE: CENTRAL PHARMA GROUP SH.P.K. - M02114010E
SELIA: TIRANE Rruga e Kosovarëve,
pranë Digës së Liqenit.

RAPORT I
AUDITUESIT LIGJOR (EKSPERTIT KONTABEL TE RREGJISTRUAR)

MBI SHTIMIN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR TE SHOQERISE

"CENTRAL PHARMA GROUP" SH.P.K.

Unë i quajtur **Arber GJATA** Auditues Ligjor (Ekspert Kontabel i Rregjistruar) i ngarkuar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "**CENTRAL PHARMA GROUP**" Sh.p.k. me Vendimin Nr. 4 të datës **07.12.2022** për verifikimin dhe vërtetimin e shtesës së kapitalit nga rritja e aktivitetit të kryera e të mbuluara nga rezerva të tjera dhe nga fonde të vetë ortakut të vetëm, paraqes raportin si më poshtë:

Drejtuar: ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "CENTRAL PHARMA GROUP" Sh.P.K., Z. Qamil DIKA

Qëllimi i Angazhimit:

Ortaku i vetëm i shoqërisë me vendimin Nr. 4 datë 07.12.2022 më ka angazhuar si Auditues Ligjor (Ekspert Kontabel i Rregjistruar) për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave të zmadhimit të kapitalit

- a) nga brenda zërave të kapitalit të vet, konkretisht nga zëri „Rezerva te tjera“
- b) nga derdhja e kontributeve në para të Ortakut të vetëm, sipas derdhjeve të paraqitura në levizjet bankare të shoqërisë për periudhën që mbyllet me 31 Dhjetor 2021 dhe përgjatë vitit 2022.

Kriteret

Si bazë për angazhimin e verifikimit të zmadhimit të kapitalit ne kemi përdorur sa më poshtë referuar:

- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit,
- Ligji Nr.25/2018 " PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE",
- Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- Pasqyrat financiare të Shoqërisë " CENTRAL PHARMA GROUP " sh.p.k., të periudhës kontabël të mbylluar më 31 dhjetor 2021 (janë të pa audituara pasi shoqëria nuk kalon kufijtë e ligjit për auditimin).
- Pasqyrat financiare të Shoqërisë " CENTRAL PHARMA GROUP " Sh.p.k. provizore për zërat e prekur nga rritja e kapitalit, të periudhës kontabël të mbyllur më 09 Dhjetor 2022 (të pa audituara).
- Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 Per tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar
- Udhezim Nr. 5 datë 30.01.2006 Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar
- Statuti i Shoqërisë „CENTRAL PHARMA GROUP“ Sh.p.k.
- Vërtetim/Konfirmim i tërhequr nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për „INDIVIDIN KONTRIBUES NË SHTIMIN E KAPITALIT NË FORMËN MONETARE NGA JASHTË SHOQËRISË“ me Nr. 34933 Prot. Dt. 24/11/2022

Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësia e Audituesit Ligjor

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin në pajtim me Standartet Nderkombetare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) "Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike" dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalin e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale.

Procedurat e kryera nga ana e Audituesit Ligjor për këtë angazhim perfshijne:

1. Verifikim i përputhshmërisë së shifrave të ndodhura në zërat e kapitalit të vet të shoqërisë dhe krijimit të këtyre posteve.
2. Verifikim i shifrave të derdhura si kontribut në para nga Ortaku i Vetëm në Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2021 dhe me 09 Dhjetor 2022.
3. Verifikimin e burimit të të ardhurave dhe vërtetimin që këto të ardhura janë të tatuara (bashkengjitur dokumentat sipas kërkesave ligjore).
4. Verifikimin e ndryshimeve në dokumentacionin Ligjor të Krijimit të Shoqërisë si Statutin, Aktin e Themelimit të Shoqërisë " CENTRAL PHARMA GROUP " SH.P.K..
5. Rishikim dhe verifikim i gjithë dokumentacionit si kontrata, vendime, akte ligjore ndihmëse për të vërtetuar vlerën e zmadhimit të kapitalit.

Zhvillimi i raportit të Audituesit Ligjor:

Shoqëria " CENTRAL PHARMA GROUP SH.P.K. " është rregjistruar si person juridik në datë 14/09/2020 dhe ka për objekt të veprimtarisë së saj:

(Hapjen, zhvillimin, menaxhimin dhe kryerjen e aktiviteteve në fushën e shëndetësisë (mjekësi, parafarmaceutike, farmaceutike, optike, higjienizim, distribuim të medikamenteve, materialeve mjekësore, integrore ushqimore, bimeve medicinale dhe çdo lloj artikulli në fushat e shëndetësisë, stomatologji, shërbime diagnostikuese mbështetëse etj). Import - eksport dhe tregëti me pakicë dhe me shumicë të artikujve dhe mallrave parafarmaceutike, farmaceutike, higjienosanitare, optike, dentare, kozmetike, veterinare, ushqimore, dietike, lende të para apo produkte dhe mallra të licencuara nga organet e tjera kompetente në rastet kur kërkohet etj. Tregëtim artikuj për femijë si ushqyes, shtesa ushqimore, biberonë ushqyes, shishe biberoni, lodra për femijë etj. Import-eksport pajisjesh mjekësore, reagentëve dhe kiteve, servis pajisjesh mjekësore dhe mirëmbajtje. Çdo aktivitet ndihmës në përputhje me legjisacionin shqiptar i cili i shërben aktivitetit të saj kryesor. Veprimtari në fushën e arsimit parauniversitar dhe universitar mbi edukimin shëndetësor. Veprimtari në turizmin mjekësor, rezervimin, kontraktimin e shërbimeve shëndetësore për të tretë. Ofrimin e shërbimit të konsulencës teknike, marketingut në veprimtarisë së bizneseve në fushën e shëndetësisë, hapjen e linjave të prodhimit farmaceutike etj. Ngritje klinikash mjekësore të specializuara ose të përgjithshme dhe shfrytëzimi i tyre, fabrikimi dhe tregëtimi i produkteve të lartpërmendura, konsulencë teknike, dhe sipërmarrje marketingu në fushën e shëndetësisë, organizimi i kurseve të trajnimit dhe edukimit afatshkurter dhe afatgjate për fushën e shëndetësisë. Dhënie në përdorim dhe me qera të aparaturave. etj. Të kryejë investime në sektorin publik në fusha të ndryshme shërbimi dhe prodhimi. Veprimtari në turizëm, hoteleri, shërbime restoranti, bar kafe, agroturizëm, agrobiznes etj. Aktivitete në fushën e turizmit si guidat turistike, paketave turistike. Promovimin e vlerave e trashëgimisë kulturore dhe traditave të zonës ku shtrihet veprimtaria shoqëria. Kuitivim dhe prodhim të kulturave bujqësore, blegtorale, bletarise, bimeve medicinale etj. Ruajtja, konservimi, përpunimi, ekspozimi, trajtimi shitja me pakicë dhe shumicë e tyre brenda dhe jashtë vendit. Krijim, menaxhim dhe zhvillim të shërbimeve në aktivitete si bar, restorant, catering, bujtina, hoteleri, plazhit etj. Krijim, menaxhim dhe zhvillim të fermave bujqësore. Organizimin e panairëve në fushat e veprimtarisë së shoqërisë. Qender e shëndetit mendor dhe fizik. Import eksport i produkteve bujqësore, blegtorale si dhe produkteve, materialeve, pajisjeve dhe shërbimeve në fushën e bujqësisë, blegtorisë, arsimit, shëndetësisë etj. Konsulenca, trajnime, analiza, raporte, ngritje kapacitetesh për institucione dhe organizata për fushat e veprimtarisë së shoqërisë. Botime të teksteve, librave dhe veprimtarive të tjera në fushën e edukimit parauniversitar dhe universitar si dhe të ofrimit të edukimit alternativ. Ofrimin e veprimtarisë në arsimin profesional. Ofrimin e shërbimit të kontrollit shëndetësor në punë, Mjekut të Punës. Shërbime ndërmjetësi dhe konsulencë në fushën e kontrollit shëndetësor në punë dhe jo vetëm. Shoqëria do të kryejë aktivitet në fushën e edukimit shëndetësor për profesionist. Kjo veprimtari, e edukimit shëndetësor do të kryhet edhe për studentet, specializantët, praktikantët dhe persona të tjerë të interesuar në fushën e shëndetit, mjekësisë së punës dhe jo vetëm, nëpërmjet organizimit të kurseve, seminareve, takimeve tematike, organizimeve shkollore dhe akademike. Ofrimi i shërbimeve të Dezinsektimit, Deratizimit dhe largimit të zverranikeve dhe shpendeve dhe çfarëdo shërbimi lidhur me eliminimin e

vektoreve te semundjeve ne shendetin publik. Ofrimi i sherbimit te pastrim dhe higjenizim te ambienteve publike dhe private. Import eksport i produkteve biocide per dezinfektim, import eksport i produkteve te pastrim higjenizim si dhe ushtrimin e aktivitetit tregetar te shitjes me shumice e pakice te produkteve pastrim-higjenizim dhe lenedeve biocide per DDD. Import eksport i lenedeve kimike dezinfektuese higjenizuese dhe te gjitha subsatancave kimike te cilat sherbejne per higjenizim dhe dezinfektim.)

Në Pasqyrat Financiare të shoqërisë të vitit 2021 rezultojnë këto të dhëna si dhe posti i azhornuar pas kontabilizimit të Vendimit të destinimit të fitimeve të vitit 2021 nga ortaku i vetëm:

		31.12.2021	Postet e kapitalit me 30.11.2022
1. Aktivet Afatshkurtëra	leke	9,894,879	-
2. Aktivet Afatgjata	leke	1,530,779	-
3. Detyrimet Afatshkurtera	leke	8,559,050	-
4. Detyrimet Afatgjata	leke	0	-
4. Kapitali	leke	2,866,608	2,866,608
Nga ky:			
● Kapitali i nënshkruar	leke	100,000	100,000
● Primi i lidhur me Kapitalit	leke	0	0
● Rezerva Rivleresimi	leke	0	0
● Rezerva Ligjore	leke	0	0
● Rezerva te tjera	leke	0	2,890,393
● Fitimi i pashperndare	leke	(123,785)	(123,785)
● Fitimi i vitit	leke	2,890,393	0

Mbi bazën e të dhënave të mësipërme del se aktivet e shoqërisë me 31.12.2021 janë gjithsej 11,425,658 lekë ndërsa detyrimet ndaj të tretëve dhe palëve të lidhura janë 8,559,050 lekë, pra kapitalet e veta të shoqërisë mbeten 2,866,608 lekë dhe përbëjnë garanci të plotë për Ortakun e vetëm të shoqërisë "CENTRAL PHARMA GROUP SH.P.K." që të rrisë kapitalin e nënshkruar të kësaj shoqërie për shumën prej totale prej 5,690,000 lekësh (sipas kërkesës së vetë subjektit).

Referuar Pikës 2.a. të Vendimit nr. 4 të datës 07.12.2022 "PER EMERIMIN E AUDITUESIT LIGJOR (EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR) PER TE BERE VLERESIMIN KONABEL TE KAPITALEVE TE SHOQERISE" të Ortakut të vetëm Rritja në Kapital do të ndodhë nga dy burime dhe më konkretisht si më poshtë paraqitur:

- 2,890,000 lekë do të kryejnë rritjen në Kapital e cila do të ndodhë nga vlerat e mbetura në zëra të kapitalit dhe më specifikisht në postin „Rezerva të tjera të tyre“ pas regjistrimeve të Vendimit Ortakut të Vetëm Nr. 01 të Dt. 14.09.2022,, Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2021 dhe të caktimit të destinacionit të fitimit të vitit 2021; Kapitali i nënshkruar kalon në vlerën totale të 2,990,000 Lekë pas kontabilizimit të kësaj rritje në kapitalin e nënshkruar.

- 2,800,000 lekë do të kryejnë rritjen në Kapital nga fonde të vetë ortakut të vetëm për të cilat do të paraqiten dhe verifikimet e kryera më poshtë në materialin e përgatitur nga ana jonë; Kapitali i nënshkruar kalon në vlerën totale prej 5,790,000 lekë pas kontabilizimit edhe të kësaj vlere rritje në kapitalin e nënshkruar.

Bazat për Konkluzione:

- Për mendimin tonë, bazuar në procedurat e kryera, procesi i Zmadhimit të kapitalit ndahet në dy burime nga ku edhe janë fokusuar verifikimet tona:
 - Fonde që vijnë nga brenda strukturës së kapitalit të shoqërisë (pranë llogarisë Rezerva të tjera). Ortaku i vetëm shprehur vullnetin e tij në Vendimin Nr. 01 të Dt. 14.09.2022 për riklasifikimin e vlerës prej 2,890,393 Lekë nga këto Rezerva brenda strukturës së Kapitalit të vet si kapital i nënshkruar. Vetë pozicionimi i këtyre

fondeve brenda strukturës së kapitalit (pra fonde nga brenda shoqërisë) jep garanci të plotë për përdoruesit e Pasqyrave financiare të saj si edhe për ortakun e vetëm për të kryer rritjen e kapitalit nga këto fonde. Duke qenë fonde te krijuara nga brenda shoqërisë këto rrisin edhe vlerën e kapitalit të paguar me të njëjtën shifër si dhe Kapitalin e Nënshkruar.

- Shumat e depozituara nga ortaku i vetëm i shoqërisë në vlerën totale të 2,817,886 Lekë. Z. Qamil DIKA ka kryer midis të tjerash depozitim në llogaritë e shoqërisë të vlerave në nivelin e 2,817,886 Lekë. Ai po në vendimin Nr. 4 të dt. 07.12.2022 ka shprehur vullnetin e tij që me këto fonde të kryhet rritja e Kapitalit të nënshkruar edhe për 2,800,000 Lekë. Zmadhimi i kapitalit është për pjesën takuese me vlerë 2,800,000 lekë, te ardhura këto nga jashtë shoqërisë "CENTRAL PHARMA GROUP" Sh.p.k. që pasi u kryen verifikimet e nevojshme e kanë burimin nga të ardhura të tatuara të shpjeguara si më poshtë vijojnë :

Lloji i te ardhures	Totali i te ardhurave Te verifikuara
Të ardhura te siguruar nga mardheniet e punesimit ne Republikën e Shqiperise nga z. Qamil DIKA per vitet 2019 dhe 2021	2,800,000

*Është për tu theksuar në këtë pjesë se në analizën e verifikimit të të ardhurave të z. Qamil DIKA nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e tij personale pasi jemi mjaftuar me përmbushjen e vlerës prej 2,800,000 lekë për të dhënë siguri të arsyeshme mbi vlerën e kërkuar nga ai si Ortak i vetëm për rritjen e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë "CENTRAL PHARMA GROUP" Sh.P.K.

** Burimi i të ardhurave është konstatuar dhe verifikuar, duke mos u kufizuar vetëm në të) në vërtetimin/konfirmimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tiranë me Nr. 34933 Prot. Dt. 24/11/2022 me qëllim vërtetimin sipas kërkesave ligjore për burimin e të ardhurave, të cilët na janë vënë në dispozicion nga pala e interesuar.

	<u>09.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Kapitali aksionar	5,790,000	100,000

Pasqyra Financiare e Kapitalit të shoqërisë, për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe shënimet e lidhura me to, japin një paqym të sigurtë dhe të vërtetë të gjendjes së depozitimeve nga ortaku i vetëm që i ka depozituar në llogaritë bankare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 dhe në vijimësi përgjatë vitit 2022.

2. Shumat e rezultuara nga pozicioni "Rezerva të tjera" prej 2,890,000 Lekë i pasqyrave financiare të shoqërisë dhe ato të depozituara nga ortaku i vetëm prej 2,800,000 Lekë janë të mjaftueshme për të realizuar shtesën e kapitalin në masën 5,690,000 lekë ku kapitali pas këtij operacioni shkon nga 100,000 Lekë në 5,790,000 lekë.
3. Llogaritjet e kryera për të përcaktuar shtesën e kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës së kuotës/pjesës së kapitalit me vlere nominale të një pjese prej 5,790,000 lekë/aksion, pasqyrojnë me vërtetësi raportin e depozitave bankare në kapital të shoqërisë. Miratohet forma juridike e zmadhimit të kapitalit:

- Z. Qamil DIKA - shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit vlere i shkon 5,790,000 lekë me 1 pjesë në zotërim.

	<u>08.12.2022</u>	<u>09.12.2022</u>
Rezerva të tjera	2,890,393	0
Te drejta e detyrime ndaj ortakeve	2,817,886	0

Veprimet kontabile që do të kryhen janë :

Debi : Llogaria "Rezerva të tjera për kapitalin e nënshkruar" 2,890,000 leke

Debi : Llogaria "Të drejta ndaj pronarëve për kapitalin e nënshkruar" 2,800,000 leke

Kredi : Llogaria "Kapitali i nënshkruar i paguar" 5,690,000 leke

PASQYRA LLOGARITJEVE TË AKSIONEVE TË KAPITALIT PËR EFEKTE TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT AKSIONAR.

Ortaku i shoqërisë	Pjesë-marrja %	Nr. pjesëve	Kapitali aktual	Zmadhimi i kapitalit në vlerë	Nr. pjesëve Pas zmadhimit	Totali i Kapitalit pas zmadhimit në vlerë
Qamil DIKA	100%	1	100,000	5,690,000	1	5,790,000
Totali		1	100,000	5,690,000	1	5,790,000

Si konkluzion përfundimtar :

Kapitali Themeltar i shoqërisë " CENTRAL PHARMA GROUP " Sh.P.K rritet për 5,690,000 lekë me 2,890,000 lekë nga grupi i kapitaleve të shoqërisë (Rezervat e tjera) dhe 2,800,000 Lekë me kontribut monetar nga jashtë shoqërisë nga fonde të vetë Ortakut të vetëm, ose nga 100,000 lekë bëhet **5,790,000** me kontribut si me poshte:

- 100 % i zotëruar nga Ortaku i vetëm Z. Qamil DIKA

**AUDITUES LIGJOR
(EKSPERTI KONTABEL I RREGJISTRUAR)**

Arber GJATA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERI TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
CENTRAL PHARMA GROUP
NIPT: M02114010E
SELIA: TIRANE Rruga e Kosovarëve, pranë Digës së Liqenit

09/12/2022

VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM
Nr 05 date 09 Dhjetor 2022

- SHQYRTIM I RAPORTIT TE AUDITUESIT LIGJOR (EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR) PER ZMADHIMIN E KAPITALIT
- MIRATIM I NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHOQERISE

Sot me datë 09/12/2022 në orën 10:am në selinë e shoqërisë "CENTRAL PHARMA GROUP" Sh.P.K. u mbledh Ortaku i vetëm i Shoqërisë.

DUKE QENE SE në mbledhje është prezent personalisht ortaku i vetëm i shoqërisë përkatësisht:

- (i) Z. Qamil DIKA - shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili zotëron 100% të Kapitalit në shoqërinë CENTRAL PHARMA GROUP Sh.P.K., me Nr. personal I50626085E.

Mbledhja ka për **rend dite**:

- Shqyrtimi i raportit të Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabël të Rregjistruar) Z. Arbër GJATA ngarkuar nga Ortaku i vetëm i shoqërisë për përgatitjen e raportit për zmadhimin e kapitalit, raport i përgatitur në datën 09.12.2022.
- Miratimi i ndryshimeve në statutin e shoqërisë si rezultat i rritjes së Kapitalit

Në përfundim të diskutimeve të tyre ortaku i shoqërisë:

V E N D O S I

1 - Të miratojë Raportin e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabel te Rregjistruar) Z. Arber GJATA të përgatitur në datën 09.12.2022 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 5,690,000 lekë në total (2,890,000 Lekë nga posti Rezerva të tjera dhe 2,800,000 Lekë nga fonde të vetë ortakut jashtë shoqërisë). Zmadhimi do të bëhet duke rritur vlerën e kapitalit.

- **Kapitali i nënshkruar i shoqërisë nga 100,000 lekë rritet dhe me 5,690,000 leke dhe behet 5,790,000 lekë.**

2 - Të miratojë ndryshimet në **Statutin e shoqërisë Neni** mbi **Kapitali i Shoqërisë** i cili riformulohet si më poshtë:

Neni 6 – KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 5,790,000 lekë (pesë milionë e shtatëqind e nëntëdhjet mijë). Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm i shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve (ortakut t vetëm). Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtëm:

- **Qamil DIKA - 100 % të kapitalit të shoqërisë**

3 - Vendimi përpilohet në 3 kopje të barasvlefshme dhe nënshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqërisë dhe Përfaqësuesi Ligjor në moshë madhore. Ky vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

- a. Një kopje i dorëzohet Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë
- b. Një kopje i dorëzohet Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabël të Regjistruar).
- c. Një kopje mbahet pranë arkivës së shoqërisë CENTRAL PHARMA GROUP Sh.p.k.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Qamil DIKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TIRANË
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE

Nr. 34933 Prot

Tiranë, më 24.1.1. / 2022

Lënda: Konfirmimi i DRT Tiranë mbi të dhënat e deklaruara nga individi kontribues në shtimin e kapitalit në formën monetare nga jashtë shoqërisë.

Për Subjektin: "Central Pharma Group" shpk me Nipt M02114010E.

Adresa: Rruga e Kosovareve, pranë Digës së Liqenit, Tiranë.

Për dijeni: QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT TIRANË

Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë, bazuar në deklarimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Central Pharma Group" shpk, me Nipt **M02114010E**, Z. Qamil Dika me nr. Personal I50626085E, mbi burimin e të ardhurave të cilat do të perdoren prej tyre për shtimin e kapitalit, pasi analizoi shumat për çdo element, të dhëna në deklaratat e tyre (kopje bashkëngjitur) dhe pas kontrollit të pagesave të tatimit mbi çdo element të dhënë prej deklaruesit, konfirmon se:

Të ardhurat sipas zërave të deklaruara janë taksuar si me poshtë vijon:

1. Nga të ardhurat e siguruara nga marrëdhëniet e punësimit të ushtruara në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2019 deri 2021 në shumën 2,800,000 lekë, për të cilën është paguar tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.
2. Nga të ardhurat nga veprimtaria kulturore apo sportive/veprimtari të tjera personale në Republikën e Shqipërisë në shumën 0 lekë është paguar tatim mbi pagë në shumën 0 leke;
3. Nga të ardhurat e siguruara nga veprimtaria a zhvilluar si jorezident, nepermjet nje personi me seli te perhershme ne Republiken e Shqiperise ne shumen 0 leke eshte paguartatim mbi page ne shumen 0 leke;
4. Nga të ardhurat e siguruara nga kalimi i se drejtes se pronesise ne Shumen 0 leke
5. Nga te ardhurat e siguruara nga pronesia mbi pasurite e paluajtshme, ne Shumen 0 leke ,paguar tatimi I mbajtur ne burim ne vleren 0 leke.
6. Nga te ardhurat e siguruara nga kalimi i pronesise mbi pasurite e paluajtshme, ne Shumen 0 leke.
7. Nga te ardhurat e siguruara nga dividendet e shperndare ne periudhen nga personi juridik , resident shqiptar ne Shumen 0 leke ne vitet fiskale - dhe ne Shumen 0 leke;
8. Nga te ardhurat e siguruara nga pjesët e fitimit në Shumen 0 leke ,te paguar nga ortakeria rezidente me vlerën 0 leke.
9. Nga te ardhurat e siguruara nga interesat ne shumen totale 0 leke;
10. Nga te ardhurat e siguruara nga e drejta e autorit apo pronesia intelektuale, qeraja, emfiteoza
11. Nga te ardhurat e siguruara ne lojrat e fatit ne shumen totale 0 leke;
12. Nga te ardhurat e siguruara prej meje si person jorezident nga sherbimet e kryera ne territorin e Republikes se Shqiperise;
13. Nga të ardhurat e tjera të siguruara qe nuk identifkohen si më lart në Shumën totale 0 lekë .

DREJTOR RAJONAL
Ram Papa

